



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SHPALLJE POZICIONI VAKANT**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

**Punonjës Mbështetës në Terren, Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit(Kategoria, klasa IX).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë:

**Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë ose dëftesë e arsimit të mesëm, (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhsimi nga MAS*);
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përbën avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

**Punonjësi Mbështetës në Terren ka për detyrë si më poshtë:**

- Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Kontrolli i territorit të Bashkisë Tiranë në lidhje me lejet e ndërtimit;
- Inspektimi i vazhdueshëm i objekteve me leje ndërtimi në të cilin është caktuar nga Drejtori i Drejtorisë dhe Kryeinspektori;
- Trajton ankesat e marra nga insitucionet qëndrore, vendore dhe subjektet fizikë e juridik. Merr masat për zgjidhjen e tyre;
- Në funksion të zbatimit të planeve mujore harton planet ditore të punës duke vendosur priorititet që i miraton tek Drejtori i Drejtorisë.

**Dokumentat që aplikanti për Punonjës Mbështetës në Terren në Drejtorinë e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit duhet të paraqesë janë si më poshtë:**

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhsimi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 15.08.2024 ora 16.30.